

BASHKIA KAVAJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

"Për dhenien me qira me konkurrim publik të pasurisë me nr 220 me indeks harte kadastrale K-34-100-(50-C) e llojit "ullishte" me sip. 15354 m² ndodhur në Z.K 2291 Kryemëdhenj Njesia Adiministrative Golem"

1. Autoriteti Qiradhenës: Bashkia Kavajë
Adresa: Rruga "Josif Budo", Ndertesa Nr.10,
Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com
Tel : 055245555

2. Te dhenat per siperfaqen: Siperfaqja prej 15354 m² e pasurisë nr. 220, lloji pasurisë "ullishte" pasuri e cila është në administrim të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë me indeks harte K-34-100- (50-C) ndodhur ne ZK. 2291 Kryemëdhenj, Njësia Administrative Golem.

3. Qellimi i dhenies me qira: Pasuria objekt i dhenies me qira do te jepet me qellim zhvillimin e veprimtarise bujqesore dhe/ose perdorim blegtoral, sipas objektit të veprimtarise së subjektit qiramarrës, veprimtari e cila do të gjeneroje të ardhura dhe nxisë punësimin.

4. Afati për dhënien me qira të pasurisë nr. 220, e llojit "ullishte" ne ZK 2291 Kryemëdhenj, Njesia Administrative Golem, do të jetë në përputhje me parashikimet e kreut IV të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" i ndryshuar, në varësi të kulturave bujqësore për të cilat do të merret me qira kjo pasuri.

5. Vlera dysheme për detyrimin e qirasë 12 000 (dymbëdhjete mijë) leke/ha për një vit kalendarik.

6. Konkurrimi publik për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë me datë 29.05.2026 në orën 11:00.

7. Vleresimi i ofertave te konkurenteve do te behet me piket si me poshte:

Niveli i investimit	40 pike
Niveli i punesimit	30 pike
Cmimi i ofruar (leke/ha vit)	30 pike

8. Subjektet konkruuese duhet të percjellin dokumentacionin si me poshte:

- Kërkesë me shkrim e cila të përmbajë të dhënat e kërkuarit, pasurinë e cila kërkohet të merret me qira e identifikuar me numrat kadastrale përkates.
- Ekstraktin e QKB-së të personit fizik apo juridik që paraqit kërkesën
- Çertifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit në QKB të personit fizik apo juridik që paraqit kërkesën.

- NUIS-in dhe vertetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqerore
- Vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti nuk është në njëkë penale si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin
- Planin e biznesit të hollësisht në të cilën të përcaktohet qartë:
 - a. veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimeve me të cilat lidhet kjo veprimtari,
 - b. aspektet kryesore të teknologjive që do të aplikohen në kultivimin e bimeve si dhe përpunimin e produkteve
 - c. investimet kryesore mbi infrastrukturen (kulli, ujitje, sistemimin etj..) të shprehura në tregues fizike dhe monetar si dhe investimet e lidhura me mbjelljen dhe kultivimin e bimeve dhe me përpunimin e produkteve etj.
 - d. Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehur në vlerë monetare
 - e. Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarëve në bashkinë përkatëse
 - f. Propozimin për cmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (leke/ha/ne vit)

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme përben kusht skualifikues.

9. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurrusi me mbishkrimin "Ofertë për marrje me qira", dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurenti/et e interesuar, fizikisht me poste ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.

11. Data e zhvillimit të konkurimit : në ambientet e Bashkisë Kavajë, me datë 29.05.2026.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: date 29.05.2026 në orën 11:00